TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. 02/08
Dt. 15.03.2013
Fushë Kosovë - Fushë Kosova -

trainkos

2012

# Raport Vjetor



Fushë Kosovë

Janar 2013

**PËRMBAJTJA:**


1. Hyrje ..... 2

2. Raport i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve..... 3

2.1. Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes..... 3

2.2. Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenten..... 6

2.3. Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutiv..... 6

2.4. Komitetet e Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.A..... 7

3. Raport i Kryeshefit Ekzekutiv..... 10

3.1. Fjala e Kryeshefit Ekzekutiv..... 10

3.2. Ngjarjet kryesore të vitit..... 12

3.3. Pasqyra e performancës operative..... 13

3.4. Pasqyra e performancës financiare dhe rezultatet..... 18

3.5. Progresi me planin e buxhetit..... 23

3.6. Projektet kapitale ..... 23

3.7. Perspektiva për vitin e ardhshëm..... 25

3.8. Rreziqet e të ardhmes së korporatës..... 27

4. Raporti sipas Ligjit mbi Ndërmarrje Publike..... 28

4.1. Struktura organizative e Trainkos Sh.A..... 28

4.2. Kontestet gjyqësore në periudhën janar-dhjetor 2012..... 31

4.3. Kontestet gjyqësore të pritura në vitin 2013..... 31

4.4. Transaksionet e realizuara..... 32

5. Përfundim..... 33


**ANEKS 1**


- Raporti lidhur me sponsorimet dhe donacionet
- Raport Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2012
- Vetëvlerësimi i Bordit të Drejtorëve

# 1. HYRJE

Fillimi i vitit 2012 operatorin e vetëm hekurudhor në Kosovë, Trainkos Sh.A, si ndërmarrje të re, e ka gjetur më të konsoliduar se në vitin paraprak. Për shkak të procesit të ndarjes së Hekurudhave të Kosovës në Trainkos dhe Infrakos, viti 2012 ishte një sfidë më vete për kompaninë, i cili u paraqit me shumë detyra dhe sfida të cilat më parë nuk i kishim hasur. Megjithëkëtë, aktiviteti kryesor i Trainkos Sh.A për këtë periudhë, ka qenë i orientuar në drejtim të realizimit të detyrave të përcaktuara më parë dhe zbatimit të planifikimeve.

Kompania ka filluar vitin 2012 me dokumentacionin bazë të kompletuar (Planin e Biznesit, Planin e Buxhetit dhe të gjitha politikat tjera të përcaktuara), mbi bazën e të cilave është zhvilluar aktiviteti dhe puna e kompanisë. Mirëpo, gjatë kësaj periudhe kishte disa faktorë të cilët kanë ndikuar dukshëm në ecurinë e realizimit të planit operativ dhe financiar të kompanisë, faktorë të cilët për rrjedhojë kanë rezultuar me ndryshime të larta me rastin e rishikimit të Planit të Biznesit dhe Buxhetit për pjesën e mbetur të vitit 2012 .

Trainkos Sh.A edhe pse një kompani e re publike vijoi të kryejë funksionin e saj të përshkruar me ligj krahas konsolidimit dhe ngritjes së kapaciteteve të veta njerëzore e materiale. Ky raport vjetor i punës për vitin 2012 ku përfshihet aktiviteti i Ndërmarrjes Publike Trainkos Sh.A do të fillojë me fjalën e Kryesuesit të BD i cili bart në vete performancën e kompanisë bashkë me aktivitetet e saj. Raporti i Kryesuesit ofron informacione edhe në lidhje me kapitalin e kompanisë dhe politikat ndikuese në zhvillimin e biznesit të saj.

Raporti më pas vijohet nga fjala-raporti i Kryeshefit Ekzekutiv duke ofruar me këtë rast të dhëna për ngjarjet kryesore për periudhën raportuese, të dhëna për performancën operative e financiare dhe progresin në drejtim të realizimit të Planit të Biznesit. Kur jemi te progresi drejt realizimit të planit të biznesit, raporti ynë ofron të dhëna të detajuara për shpenzimet, investimet kapitale të kompanisë dhe gjithashtu një elaborim të çështjes së perspektivës bashkë me rreziqet e mundshme ndikuese. Po ashtu brenda raportit është paraqitur edhe skema organizative e stafit të kompanisë, ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe si dhe një pjesë e raportit i është kushtuar çështjeve të ndryshme të lidhura me kontestet gjyqësore.

Për të qenë raporti sa më i qartë dhe i kompletuar, brenda tij janë paraqitur edhe grafikone, tabela statistikore e skema tjera me sqarime të nevojshme.

Raporti Vjetor 2012 i Trainkos Sh.A ka të bashkëngjitur edhe shtojcën apo Aneksin 1, i cili përmban të dhëna tjera shtesë të cilat mbesin për përdorim të aksionarit.
Në përpjekje të realizimit të këtij raporti, për të pasqyruar aktivitetet e kompanisë, suksesin e saj në realizimin operativ e financiar, gjithsesi që jemi bazuar edhe në udhëzuesin në lidhje me hartimin e raportit vjetor dhe po ashtu edhe në Ligjin për NP.

## 2. RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

**Të nderuar aksionarë!**

Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës "Trainkos" Sh.A me përkushtim i është qasur punës në konsolidimin e ndërmarrjes së re dhe me përgjegjësi ka kryer obligimet e veta ligjore. Në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare (Nr. 02/L-123), Bordi i Drejtorëve i Trainkos Sh.A, në emër të aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin edhe nga ligjet tjera të aplikueshme për NP-të. Hartimi i politikave dhe dokumenteve tjera strategjike për kompaninë si dhe mbikëqyrja e vazhdueshme në zbatimin e tyre ka qenë fokusi kryesor i BD për një qeverisje korporative të ndërmarrjes.

Në saje të këtij angazhimi të të gjithë drejtorëve të bordit nuk kanë munguar as sukseset në përmbushjen e obligimeve.

Ne, në vijim, në këtë raport-vështrim do të paraqesim të dhënat mbi aktivitetet, performancën e ndërmarrjes dhe të dhëna tjera të rëndësishme për vitin 2012.

### 2.1. AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDËRMARRJES

Prezantimi i Raportit Vjetor të Punës për vitin 2012 për NP Trainkos Sh.A është i lidhur dhe i kushtëzuar nga një periudhë sfiduese e cila ka ardhur si pasojë e kushteve klimatike, krizës ekonomike në lëmin e minierave, problemeve me linjën hekurudhore (sidomos tuneli i Gajres), e deri te problemet rreth konsolidimit të mëtejmë.

Viti 2012, për Hekurudhat e Kosovës ishte vit i sfidimit. Ndërmarrja Trainkos Sh.A e gjetur në këto rrethana sfiduese nuk mbeti pa u ndikuar në aktivitetet e veta të përditshme në veçanti dhe në performancen e saj në përgjithësi. Këto rrethana nuk vareshin nga ne por kishin ndikim të madh në punën tonë.

Sfidat me të cilat u ballafaquam në rrethanat e reja ishin të ndryshme. Përderisa, në njërën anë, kërkohej konsolidimi i ndërmarrjes së re për të zhvilluar biznesin pandërprerje në ofrimin e shërbimeve për klientët dhe qytetarët tanë, në anën tjetër, kërkohej vazhdimi i kompletimit me dokumente strategjike e ligjore, mbi bazën e të cilave duhej të zhvillohej aktiviteti i ndërmarrjes-Trainkos Sh.A. Ne ia dolëm që t'i përmbushim të gjitha këto obligime falë angazhimit të palodhshëm të BD dhe menaxhmentit.

## • Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2012

Ne jemi përkushtuar në arritjen e caqeve financiare të përcaktuara në Planin e Buxhetit të kompanisë. Duke qenë të detyruar nga gjendja në operime për shkak të rrethanave që u cekën edhe më lart, vlen të përmendet fakti se dy muajt e parë të vitit, pothuajse nuk kishte fare transport të mallrave. Pastaj, jo rrallë herë janë shfaqur edhe problemet në qarkullim në tunelin e Gajres. Dhe, problemi më i madh që na doli ishte edhe operimi i kufizuar i klientit tonë kryesor Ferronikel, i cili ndikoi shumë në performancën tonë. Andaj, me rastin e rishikimit të Planit të Biznesit dhe Planit të Buxhetit u detyruam që të bëjmë edhe ndryshime të mëdha, nga planifikimi i parë, dhe falë angazhimit të vazhdueshëm të stafit të kompanisë kemi arritur që të tejkalojmë objektivat e parapara me rishikim të buxhetit. Jemi krenarë që arritëm këtë rezultat duke pasur parasysh krizën që kishim, sidomos deri në mes të vitit 2012. Trainkosi përkundër këtyre vështirësive e pengesave arriti që me punë e përkushtim të mos ndërprejë asnjëherë operimin dhe të mbajë në funksion të gjitha linjat e planifikuara për transport të udhëtarëve. Gjithashtu ndërmarrja jonë ka arritur të kalojë suksesshëm këtë periudhë edhe në kuptimin e menaxhimit me resurse njerëzore duke mos larguar asnjë punëtorë nga puna edhe pse puna dhe aktivitetet e kompanisë, rrjedhimisht edhe fitimet e saj kishin shënuar rënie. Përveç kësaj nuk kishte ulje dhe vonesa në paga dhe tani jemi dukshëm më të relaksuar falë punës së përbashkët në ketë drejtim.

Krahas këtyre sfidave, ne u përballëm edhe me procesin e përzgjedhjes së zyrtarëve të lartë të ndërmarrjes, me dorëheqjen e Kryeshefit dhe me përzgjedhjen e Kryeshefit të ri. Besojmë se kemi arritur suksesshëm që t'i përballojmë edhe këto proceseve.

Ndërsa, duhet theksuar se ne u përkushtuam edhe në realizimin e objektivave në fushën e bashkëpunimit me institucionet vendore e ndërkombëtare, ku mund të themi me përgjegjësi se kemi arritur të avancojmë jashtëzakonisht shumë në ndërtimin e një bashkëpunimi shumë domethënës në ketë drejtim.

Kujdes të posaçëm i kemi kushtuar edhe licencimit dhe përmbushjes së obligimeve ligjore në raport me ARH-në dhe institucionet tjera. Tani jemi në fazën e zhvillimeve të hovshme të licencimit në të gjitha fushat e parapara me ligj. Sfidë mbetet që në vazhdim të avancojmë edhe në raport me licencimet nga mekanizmat ndërkombëtarë qoftë për operime, mirëmbajtje etj.

## • Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual

Performanca financiare e Kompanisë, sikurse është e pasqyruar edhe në pjesën tabelare por edhe përshkruese të këtij raporti, është për mbi 500 mijë euro më e mirë se sa që e kemi planifikuar. Por, duhet theksuar se performanca financiare ka qenë e ndikuar

nga fakti se nuk janë mbuluar shpenzimet e qarkullimit të trenave të udhëtareve, ashtu siç e parasheh Ligji për Hekurudhat. Mosmbulimi i humbjeve me marrëveshjen për shërbimet publike (PSO), nga ana e Qeverisë ka bërë që fitimin e qarkullimit të transportit të mallrave ta përdorim për mbulimin e humbjeve në transportin e udhëtareve (shuma e pambuluar nga Aksionari për këto shpenzime është 895,845.88€.) Po ashtu një ngarkesë e lartë për buxhetin e kompanisë ka qenë edhe marrëveshja për pagesat e qasjes në binarë, e cila është paguar në shumën fikse prej 134,000€ edhe atëherë kur nuk ka pasur qarkullim. Kjo marrëveshje është bërë edhe me preferencën e Aksionarit me qëllim që Infrakos t'i ketë të mbuluara shpenzimet operative. Nga kjo marrëveshje, vlera totale e dëmtimit të kompanisë është mbi 600.000€. Ky konstatim del sipas kalkulimeve që janë bërë në bazë të Deklaratës së Rrjetit dhe Marrëveshjes me Infrakos për Shërbimet e Përbashkëta për periudhën janar shkurt 2013. Muaji janar dhe shkurt 2013 është periudha që ka pasur realizim operativ maksimal dhe për këtë periudhë kemi paguar 118,901€ më pak se për periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kur nuk kemi pasur pothuajse fare qarkullim.

- Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes

Sfidat për vitin në vijim, si dhe për të ardhmen, mbeten sfidat për plotësimin e politikave (rregulloreve) bazike. Po ashtu, sfidë e vazhdueshme mbetet mbikëqyrja e punës menaxheriale si dhe përpilimi e hartimi i politikave strategjike për zhvillim të kompanisë. Në këtë kontekst, BD, është i përkushtuar të ndërmarrë nismat që janë në përgjegjësi të tij, që projekteve paraprake t'u japë shtytje për realizim. Aspekti i strukturës së stafit të punonjësve do të jetë sfidë më vete; siç është përtëritja e stafit ku mosha mesatare e punëtorëve është tejet e lartë dhe përmirësimi i strukturës gjinore.

- Të priturat për vitin e ardhshëm

Një prej synimeve tona, padyshim që është planifikimi i investimeve në modernizimin e mjeteve lëvizëse dhe, pse jo, në blerjen e mjeteve të reja. Për ketë jemi të vetëdijshëm se është një mision i vështirë, por me ndihmën e aksionarit dhe me ato pak mundësi tona financiare, pa lënë anash edhe mundësinë për gjetjen e donatorëve, ku kemi realizuar shumë takime dhe jemi në negociata me disa mekanizma ndërkombëtarë për të siguruar donacione apo forma tjera të përshtatshme dhe të leverdishme për investime në modernizim dhe avancim teknologjik, shpresojmë se do të kemi sukses.

Si përfundim, marrë në përgjithësi nëse shikojmë trendin e zhvillimit të kompanisë, për Hekurudhat e Kosovës, Trainkos Sh.A, vitin 2012 do ta quajmë vit të përballimit të suksesshëm të sfidave të mëdha. Ndërsa, së bashku do angazhohemi që vitin 2013, me punë dhe rezultate, ta pagëzojmë si vitin model të zhvillimit dhe avancimit të Hekurudhave të Kosovës Trainkos Sh.A.

## 2.2. INFORMACIONE LIDHUR ME KAPITALIN DHE DIVIDENTEN

Sa i përket investimeve kapitale për vitin 2012 vlen të përmendet se investimet më të rëndësishme të ndërmarrjes, janë orientuar në riparimin e një lokomotive dhe një seti të trenave motorikë, të cilat do kenë një siguri më të madhe për një qarkullim të sigurtë dhe pa probleme.

Një e dhënë tjetër që duhet theksuar është edhe fakti se Ndërmarrja "Trainkos" Sh.A, gjatë këtij viti nuk ka nënshkruar asnjë marrëveshje kredituese gjë e cila na bën të ndihemi mirë se, ndërmarrjen nuk e kemi futur në asnjë borxh, e që do ndikonte negativisht në operimet në vazhdim.

Ndërsa sa i përket ndarjes së dividentës, kompania nuk ka arritur atë nivel të performancës së vet për të realizuar atë ashtu siç është e paraparë me aktet juridike të cilat rregullojnë këtë çështje.

## 2.3. TË DHËNAT PËR DREJTORËT JO-EKZEKUTIVË

Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të Hekurudhave të Kosovës “Trainkos” Sh.A është emëruar me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr. 04/24 të datës 20.07.2011, ndërsa me Vendimin tjetër të Qeverisë me Nr. 27/53 të datës 21.12.2011 i është vazhduar mandati deri në përzgjedhjen e Bordit të ri. Në bazë të këtij vendimi si dhe të LNP, Bordi i Drejtorëve në emër të Aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin nga ligjet tjera të aplikueshme për NP-të.

Gjatë vitit 2012 Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të Hekurudhave të Kosovës “Trainkos” Sh.A ka mbajtur gjithsej 15 mbledhje, dy prej të cilave kanë qenë të jashtëzakonshme si dhe Mbledhja e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin. Po ashtu edhe konsultat dhe kontaktet tjera midis drejtorëve të Bordit dhe menaxhmentit të kompanisë kanë qenë të shpeshta. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Bordit, numri i mbledhjeve të mbajtura gjatë vitit 2012 si dhe pjesëmarrja e drejtorëve në këto mbledhje:

- Përbërja e Bordit të Drejtorëve të HK Trainkos Sh.A.

| **Përbërja e Bordit të Drejtorëve të HK Trainkos Sh.A** | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Emri dhe Mbiemri** | **Pozita** | **Pjesëmarrja në mbledhje** |
| 1 | Hasan Ibraj | kryesues | 15 |
| 2 | Heset Cakolli | anëtar | 15 |
| 3 | Labinot Halilaj | anëtar | 15 |
| 4 | Shkumbin Hyseni | anëtar | 15 |
| 5 | Betim Gjoshi | KE, nga dt. 01.10.2012 | 4 |

## 2.4. KOMITETET E BORDIT TË DREJTORËVE TË TRAINKOS SH.A

Që nga emërimi i Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.A, me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore dhe arritjes së performancës së kompanisë, punën e tij e kanë ndihmuar edhe komitetet e krijuara nga vetë Bordi i Drejtorëve si dhe Komisioni i Auditimit i cili është formuar nga Aksionari. Disa prej komiteteve të BD, pasi që është vlerësuar se nuk janë të domosdoshme, ato edhe janë shpërberë, por në ndërkohë janë krijuar edhe komitete të reja për çështje të caktuara të cilat kanë kërkuar trajtim më specifik.

Janë gjithsej shtatë komitete të Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.A, duke llogaritur edhe Komisionin e Auditimit, të cilat kanë funksionuar gjatë vitit 2012. Nga numri i përgjithshëm i këtyre komiteteve, dy prej tyre janë shpërberë (Komiteti i Financave dhe ai për Hulumtime dhe Teknologji), ndërsa janë formuar tri komitete të reja (Komiteti për Asete, Komiteti për të Arkëtueshmet dhe të Pagueshmet si dhe Komiteti për Projekte Kapitale).

Kontributi i komiteteve ka qenë tejet i rëndësishëm në definimin e shumë çështjeve dhe lehtësimin e punëve të vetë Bordit. Në pjesën në vijim të këtij raporti do të paraqesim një përshkrim të shkurtër për përbërjen e tyre, datën e formimit apo shpërbërjes si dhe numrin e takimeve të mbajtura gjatë vitit 2012:

**Komisioni i Auditimit** i Hekurudhave të Kosovës Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Aksionarit Nr. 01/159 më datë 07.09.2011. Gjatë vitit 2012 Komisioni ka mbajtur gjithsej 16 mbledhje. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komisionit:

| **Përbërja e Komisionit të Auditimit** | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Emri dhe Mbiemri** | **Pozita** | **Pjesëmarrja në mbledhje** |
| **1** | Labinot Halilaj | kryesues | 16 |
| **2** | Heset Cakolli | anëtar | 16 |
| **3** | Shkumbin Hyseni | anëtar | 16 |

**Komiteti për Staf dhe Shpërblime** i Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Bordit të Drejtorëve më datë 25.08.2011. Gjatë vitit 2012 Komisioni ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komitetit:

| **Përbërja e Komiteti për Staf dhe Shpërblime** | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Emri dhe Mbiemri** | **Pozita** | **Pjesëmarrja në mbledhje** |
| **1** | Shkumbin Hyseni | kryesues | 12 |
| **2** | Hasan Ibraj | anëtar | 12 |
| **3** | Labinot Halilaj | anëtar | 12 |
| **4** | Besfort Metaj | anëtar nga menaxhmenti | 11 |

**Komiteti për Asete** i Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Bordit të Drejtorëve më datë 25.07.2012, ndërsa më datë 30.10.2012 është bërë plotësimi i këtij komiteti edhe me një anëtar të ri. Gjatë vitit 2012 Komiteti ka mbajtur gjithsej 4 mbledhje. Vlen të theksohet se ky komitet ka bërë një punë të jashtëzakonshme në definimin e çështjeve problematike lidhur me asetet, probleme të trashëguara që nga ndarja e HK-së e tutje. Puna e këtij komiteti është në përfundim e sipër. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komitetit:

**Përbërja e Komiteti për Asete**

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Pozita | Pjesëmarrja në mbledhje |
|---|---|---|---|
| **1** | Hasan Ibraj | kryesues | 4 |
| **2** | Heset Cakolli | anëtar | 4 |
| **3** | Labinot Halilaj | anëtar nga 30.10.2012 | 2 |
| **4** | Besim Asllani | anëtar nga menaxhmenti | 3 |

**Komiteti për të Arkëtueshmet dhe të Pagueshmet** i Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Bordit të Drejtorëve më datë 25.07.2012, ndërsa më 30.10.2012 është bërë plotësimi i këtij komiteti edhe me një anëtar të ri. Gjatë vitit 2012 Komiteti ka mbajtur gjithsej 6 mbledhje. Po ashtu edhe ky komitet ka trajtuar shumë çështje problematike dhe ka bërë një punë të jashtëzakonshme në definimin e çështjeve lidhur me të arkëtueshmet dhe të pagueshmet. Për këto çështje poblematike të trashëguara që nga ndarja e HK kemi pasur edhe rekomandimet nga Auditori i Jashtëm të cilat pothuajse veç kanë marrë zgjidhjen e duhur. Puna e këtij komiteti është në përfundim e sipër. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komitetit:

**Përbërja e Komiteti për të Arkëtueshmet dhe të Pagueshmet**

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Pozita | Pjesëmarrja në mbledhje |
|---|---|---|---|
| **1** | Labinot Halilaj | kryesues | 6 |
| **2** | Shkumbin Hyseni | anëtar | 6 |
| **3** | Hasan Ibraj | anëtar | 6 |
| **4** | Heset Cakolli | anëtar nga 30.10.2012 | 3 |
| **5** | Zair Imeri | anëtar nga menaxhmenti | 6 |

**Komiteti për Projekte Kapitale** i Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Bordit të Drejtorëve më datë 23.10.2012. Gjatë vitit 2012 Komiteti ka mbajtur gjithsej 3 mbledhje. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komitetit:

| Përbërja e Komitetit për Projekte Kapitale | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Emri dhe Mbiemri** | **Pozita** | **Pjesëmarrja në mbledhje** |
| **1** | Heset Cakolli | kryesues | 3 |
| **2** | Hasan Ibraj | anëtar | 3 |
| **3** | Shkumbin Hyseni | anëtar | 3 |

**Komiteti i Financave** i Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Bordit të Drejtorëve më datë 25.08.2011. Komiteti ka funksionuar deri më 24.08.2012 kur është marrë vendimi i BD për shpërbërje të tij. Gjatë vitit 2012 Komiteti ka mbajtur gjithsej 5 mbledhje. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komitetit:

| Përbërja e Komitetit të Financave | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Emri dhe Mbiemri** | **Pozita** | **Pjesëmarrja në mbledhje** |
| **1** | Hasan Ibraj | kryesues | 5 |
| **2** | Labinot Halilaj | anëtar | 5 |
| **3** | Heset Cakolli | anëtar | 5 |

**Komiteti për Hulumtime dhe Teknologji** i Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Bordit të Drejtorëve më datë 25.08.2011. Komiteti ka funksionuar deri më 24.08.2012 kur është marrë vendimi i BD për shpërbërje të tij. Gjatë vitit 2012 Komiteti ka mbajtur gjithsej 6 mbledhje. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komitetit:

| Përbërja e Komitetit për Hulumtime dhe Teknologji | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Emri dhe Mbiemri** | **Pozita** | **Pjesëmarrja në mbledhje** |
| **1** | Heset Cakolli | kryesues | 6 |
| **2** | Hasan Ibraj | anëtar | 6 |
| **3** | Shkumbin Hyseni | anëtar | 6 |

***Në emër të Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.A***
***Mr.Sc. Hasan Ibraj - Kryesues***

# 3. RAPORT I KRYESHEFIT EKZEKUTIV

## 3.1. FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

**Të nderuar aksionarë të Trainkos Sh.A!**

Viti që kaluam operatorin e vetëm hekurudhor në Kosovë, Trainkos Sh.A, si ndërmarrje të re e ka gjetur më të konsoliduar se në vitin paraprak. Periudha që lamë pas, përkatësisht viti 2012, është viti që solli risi në organizimin dhe funksionimin e Hekurudhave të Kosovës, përkatësisht është periudha e cila karakterizohet me përshtatjen në funksionim pas ndarjes në dy kompani të reja nga Hekurudhat e Kosovës.

Me punën që kemi treguar në drejtim të përafrimit dhe kompletimit të infrastrukturës ligjore, strukturimit, llojllojshmërisë së shërbimeve, ne jemi duke operuar dhe performuar suksesshëm. Kompania ka filluar vitin 2012 me aktet bazë të kompletuara (Planin e Biznesit, Planin e Buxhetit dhe të gjitha politikat tjera të përcaktuara), me qëllim të arritjes së objektivave të planifikuara. Mirëpo, gjatë kësaj periudhe kishte disa faktorë të cilët kanë ndikuar dukshëm në ecurinë e realizimit të planit operativ dhe financiar të kompanisë, e si rrjedhojë është bërë rishikimi i Planit të Biznesit dhe Buxhetit për pjesën e mbetur të vitit 2012. Trainkos Sh.A megjithëse një kompani e re e posa themeluar, e cila filloi punën me kapacitete të pakompletuara tërësisht, arriti të përmbushë pritjet më optimiste për këtë vit. Ishte angazhim maksimal i tërë stafit, Bordit të Drejtorëve, menaxhmentit dhe të tërë punonjësve ajo që e bëri të mundur përmbylljen e suksesshme të këtij viti.

Si ngjarje që mund të theksohen gjatë vitit është se kompania ka tejkaluar planifikimet e Planit te Biznesit. Shpenzimet kanë qenë brenda kufijve të parashikuar, është ngrit transporti i mallrave, është punuar në rregullativën e brendshme, është konsoliduar stafi, ka filluar kompania të pajiset me licencat e nevojshme nga ARH-ja.

Të kesh fatin të jesh pjesë e një stafi që merr përsipër barrën e zhvillimit të një kompanie të re, me rëndësinë dhe përmasat e aktivitetit të Trainkos-it, e dimë se nuk është detyrë e lehtë. Por, përkundër që periudha për të cilën po flasim është periudhë relativisht me sfida, ne kemi arritur që të realizojmë shumë nga detyrat që ia kishim parashtruar vetes në fillim të kësaj periudhe njëvjeçare, përkundër të gjithë faktorëve që kanë mundur negativisht të ndikojnë në performancën tonë.

Kemi punuar me kujdes të shtuar që të ofrojmë për qytetarët dhe bizneset shërbimet e nevojshme si në transportin e mallrave ashtu edhe në atë të udhëtarëve. Kemi përmbyllur vitin me një rezultat të kënaqshëm operativ duke ruajtur trendin pozitiv të ngritjes së transportit të mallrave përkundër shumë sfidave që kemi pasur me konkurrencën, mjetet lëvizëse të vjetruara dhe kufizimeve të lëvizjeve në linjën funksionale për shkak të punimeve në rinovimin e “Tunelit Gajre”. Po ashtu edhe lidhja me hekurudhat e vendeve tjera vazhdon ende të jetë sfiduese, ku të vetmen lidhje e kemi

përmes Maqedonisë dhe kjo në masë të madhe e ka vështirësuar performancën tonë, sidomos atë të transportit të mallrave.

Angazhimet tona të deritashme kanë të bëjnë edhe me hartimin e politikave strategjike me qëllim të përcaktimit të orientimeve dhe qasjeve biznesore të kompanisë. Këto politika janë plotësisht në përputhje me praktikat më të mira të të bërit biznes dhe synojnë ofrimin e shërbimeve sa më të mira përshtatur me rrethanat në të cilat gjendet Kosova. Me qëllim të arritjes së objektivave tona, jemi të angazhuar në arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit si në rrafshin kombëtar ashtu edhe atë ndërkombëtar për të avancuar edhe më funksionimin e kompanisë.

Trainkos, tanimë është një kompani e organizuar mirë dhe e koncentruar në njësi biznesi, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve sa më efikase dhe efektive për bizneset dhe qytetarët. Bizneset e Trainkos Sh.A janë të përqendruara momentalisht në transportin e mallrave, atë të udhëtarëve, mirëmbajtjen e lokomotivave dhe trenave motorikë, mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave si dhe të udhëtarëve. Por, synim yni është që kompania të zgjerohet edhe në ofrimin e shërbimeve dhe zgjidhjeve logjistike që lidhen ngusht me këto veprimtari, me objektiv parësor që të ofrohen pako shërbimesh sa më efektive dhe efikase.

Trainkos Sh.A, gjatë kësaj periudhe ka vazhduar me projektet për investime kapitale, me qëllim që parkun e mjeteve lëvizëse ta bëjmë sa më shumë funksional.

Pas kryerjes së riparimit gjeneral të një lokomotive si dhe riparimit të mesëm të dy trenave motorikë të udhëtarëve, ne do të mund t'u ofrojmë qytetarëve shërbime më efikase dhe më cilësore.

Ajo çfarë synojmë për vitin e ardhshëm bazuar në Planin e Biznesit i cili ka ngritur disa objektiva të cilat synojmë dhe jemi të përkushtuar që t'i realizojmë brenda vitit 2013: Objektivi ynë në tregun e transportit të mallrave është që në këtë treg planifikojmë të kemi rritje të shitjeve krahasuar me vitin 2012, në tregun e transportit të udhëtarëve është që të kemi ngritje të numrit të udhëtarëve, sidomos ngritje të të hyrave, të ofrojmë kushte të mira pune për stafin e Trainkos, si dhe një varg objektivash të cilat janë të përcaktuara qartë nga ne në Planin e Biznesit.

Ne si kompani përballemi me një numër të rreziqeve, që sidomos vijnë nga tri grupe faktorësh (politikë, teknikë, dhe faktorë tjerë të jashtëm):

Faktorët politikë janë faktorë me të cilët përballet në përgjithësi i tërë shteti ynë. Si pasojë e këtyre problemeve, ne sot të vetmen lidhje me hekurudhat e kemi përmes Maqedonisë që është jo e favorshme për ne. Mandej nga ky grup faktorësh, sfidë më vete është se ne nuk jemi të njohur ndërkombëtarisht si hekurudha.

Në grupin e dytë të rreziqeve janë faktorët teknikë, sidomos numri i vogël i mjeteve lëvizëse, vjetërsia e tyre, kostoja e mirëmbajtjes etj.

Ndërsa, faktorët e tjerë që ne kemi të lidhur fatin tonë janë të shumtë. Infrastruktura e dobët, mos mbulimi i humbjeve në transportin e udhëtarëve sipas ligjeve në fuqi (ashtu siç parashihet marrëveshja PSO), kriza ekonomike etj.

Trainkos Sh.A në prizëm afatshkurtër është në pozitë të mirë të funksionimit dhe në rrugë të mirë gjithashtu të sigurimit të ecjes së vet drejt suksesit. Kjo nuk do të thotë që ne kemi realizuar çdo detyrë e cila varet prej nesh. Jemi të vetëdijshëm që neve na presin edhe shumë detyra e angazhime të reja të cilat besojmë se do t'i realizojmë, duke u mbështetur edhe në përkrahjen e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik si dhe në mbështetjen e Ministrisë së Infrastrukturës. Bashkë mendojmë se do t'ia dalim që të kemi një ngritje të cilësisë të punës sonë dhe përmbushje të vizionit dhe misionit të Trainkos.

***Kryeshefi Ekzekutiv***
***Betim Gjoshi***

## 3.2. NGJARJET KRYESORE TË VITIT

Njëra prej ngjarjeve më të veçuara me te cilën jemi ballafaquar qysh në fillim të vitit 2012, kanë qenë kushtet klimatike ato të cilat kanë ndikuar dukshëm në realizimin operativ të kësaj periudhe. Muaji shkurt kishte qenë me temperatura tejet të ulëta e me reshje të mëdha të borës - të cilat kishin detyruar bizneset që të ndërpresin punën e tyre e në këtë mënyrë edhe transportimin e mallrave me tren. Përveç kësaj një ndikim të madh ka pasur edhe operimi me kapacitete të përgjysmuara të prodhimit nga partneri ynë kryesor – New Co Ferronikeli.

Duke pasur parasysh këtë gjendje, menaxhmenti ka marrë të gjitha masat që shpenzimet të reduktohen deri në minimum duke pezulluar edhe disa projekte të planifikuara. Në këto rrethana është bërë rishikimi i Planit të Biznesit dhe Planit të Buxhetit për periudhën vijuese të vitit 2012 dhe falë angazhimit dhe përkushtimit të shtuar është arritur që viti 2012 të përmbyllet me realizimin prej 113.65 % të Planit të Biznesit dhe të Buxhetit të rishikuar.

Çështje tjetër me rëndësi për vitin 2012 është edhe miratimi i Deklaratës së Rrjetit edhe pse ajo ende nuk ka filluar të zbatohet.

Ngjarje e veçantë në vitin 2012 është edhe Licencimi i Trainkos për Kryerjen e Shërbimeve të Transportit Hekurudhor në Republikën e Kosovës nga ARH.

Po ashtu, edhe arritja e Marrëveshjes me MI për Shërbimet Publike është e një rëndësie të veçantë.


## 3.3. PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE E TRAINKOS SH.A

Në këtë pjesë të raportit janë paraqitur indikatorët fizikë të performancës sonë operative gjatë periudhës janar – dhjetor, duke prezantuar realizimin operativ gjatë periudhës vjetore 2012 krahasuar me planifikimin për të njëjtën periudhë me realizimin e vitit paraprak. Po ashtu komentojmë ndryshimet që kanë ndodhur gjatë kësaj kohe.

### Transporti i mallrave


Në fushën e biznesit të transportit të mallrave, e cila ka rëndësinë kryesore për ne, gjatë kësaj periudhe kemi këto rezultate:

| Përshkrimi - Sasia e transportuar | Janar - Dhjetor |
|---|---|
| Realizim neto ton 2011 | 1,005,871 |
| Realizim neto ton 2012 | 747,416 |
| Planifikim neto ton 2012 | 466,741 |
| Dallimi realizim 2012 - realizim 2011 | -258,455 |
| Dallimi realizim - planifikim 2012 | 280,675 |
| Dallimi realizim 2012 - realizim 2011 | -26% |
| Dallimi realizim - planifikim 2012 | 60% |
| | |




Siç mund të shihet nga shënimet më lart, në këtë periudhë kohore kemi transportuar për rreth **-26%** më pak sesa periudhën vjetore të vitit të kaluar, ndërsa kemi tejkaluar sasinë e planifikuar për këtë periudhe për rreth **60%**.

| Përshkrimi - Të hyrat | Janar- Dhjetor |
|---|---|
| Realizim shitje të hyra 2011 | 3,052,985.57 |
| Realizim shitje të hyra 2012 | 2,755,918.00 |
| Buxheti i Rishikuar 2012 | 2,004,180.33 |
| Dallimi realizim 2012-realizim 2011 | -297,067.57 |
| Dallimi realizim-planifikim 2012 | 751,737.67 |
| Dallimi realizim 2012-realizim 2011 | -10% |
| Dallimi realizim-planifikim 2012 | 38% |




Vlen të përmendet rasti i transportit të mallrave, ku kemi tejkalim të parashikimit nga buxheti i rishikuar. Madje nëse krahasohet me vitin paraprak, kemi realizim rreth 90% që duke marrë parasysh vështirësitë e fillimvitit dhe krizën ekonomike në Greqi, pastaj problemet teknike që kishte klienti ynë kryesor Ferronikeli, atëherë mund të themi se kemi rezultat shumë të mirë në raport me atë që kemi planifikuar. Kemi rreth 600 mijë euro fitim nga operimi me mallra, mjete këto që janë përdorur në Transportin e Udhëtarëve (si shkak i mos mbulimit të humbjeve të transportit të udhëtarëve sipas Ligjit të Hekurudhave-OSHP-së)

Ndërsa, nga realizimi financiar i transportit të mallrave, siç mund të shihet nga shënimet më lart, në këtë periudhë kohore është arritur të krijohen të hyra për rreth **-10%** më pak sesa vitin e kaluar për të njëjtën periudhë, ndërsa kemi tejkaluar planifikimin e rishikuar për **38%** për periudhën raportuese.

Ekzistojnë dy arsye të tejkalimit të buxhetit të rishikuar, e para është planifikimi i saktë që kemi bërë me rishikim të buxhetit, ku për shkak të periudhës shumë të keqe gjatë pjesës së parë të vitit kemi vendosur të mbajmë planifikimin shumë të matur dhe arsyeja e dytë është transporti për kompaninë New Co Ferronikel (ku nga fundi i tetorit kemi një ngritje të transportit vendor deri në 4 trena në ditë) e cila ka ndikuar dukshëm në performancën e të hyrave tona.

## Të hyrat dhe shpenzimet nga biznesi i transportit të mallrave

| Përshkrimi | Janar- Dhjetor |
|---|---|
| **Shitjet nga transporti i mallrave** | **2,707,617.00** |
| **Shitjet nga shërbimet tjera të transportit të mallrave** | **48,301.00** |
| **Total shitjet** | **2,755,918.00** |
| **Shpenzimet direkte në transportin e mallrave** | **1,840,075.00** |
| **Shpenzimet indirekte në transportin e mallrave** | **337,839.4** |
| **Total shpenzimet** | **2,177,914.00** |
| **Fitimi/humbja operative** | **578,004.00** |


Siç shihet nga tabela më lart biznesi i transportit të mallrave ka operuar me një fitim operativ prej 21**%** gjatë periudhës raportuese.

Vërejtje:
*Shpenzimet indirekte janë përllogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave për vitin 2012 duke marrë për bazë trenkilometrat, ku ka rezultuar se trenat e mallrave kanë operuar rreth 30% nga totali i trenkilometrave që kanë operuar të gjithë trenat.*

## Transporti i udhëtarëve


Në fushën e biznesit të transportit të udhëtarëve gjatë kësaj periudhe kohore të raportimit ne kemi pasur këto rezultate.

| Përshkrimi-Udhëtarë | Janar- Dhjetor |
|---|---|
| **Realizim numri i udhëtarëve 2011** | **357 725** |
| **Realizim numri i udhëtarëve 2012** | **366 537** |
| **Planifikimi numri i udhëtarëve 2012** | **368 457** |
| **Dallimi realizim 2012-realizim 2011** | **8 812** |
| **Dallimi realizim-planifikimi 2012** | **- 1. 920** |
| **Dallimi realizim 2012-realizim 2011** | **2%** |
| **Dallimi realizim-planifikimi 2012** | **-0.6%** |




Siç shihet nga shënimet e paraqitura më lart, sa i përket transportit të udhëtarëve për këtë vit ne kemi pasur numër më të madh të udhëtarëve krahasuar me vitin e kaluar. Planifikimi i numrit të udhëtarëve për këtë vit ka qenë 3% më shumë se viti i kaluar dhe ne kemi arritur të realizojmë 99.4% të planifikimit.

| Përshkrimi- Shitje e biletave | Janar - Dhjetor |
|---|---|
| **Realizim shitje të hyra 2011** | **212,346.52** |
| **Realizim shitje të hyra 2012** | **229,844.00** |
| **Buxheti shitje të hyra 2012** | **218,716.92** |
| **Dallimi realizim 2012-realizim 2011** | **17,497.48** |
| **Dallimi realizim-buxhet 2012** | **11,127.08** |
| **Dallimi realizim 2012-realizim 2011** | **8%** |
| **Dallimi realizim-buxhet 2012** | **5%** |




Ndërsa reflektimi financiar i transportit të udhëtarëve, siç mund të shihet nga shënimet më lart, në këtë vit është arritur të krijohen të hyra nga shitja e biletave për rreth 8% më shumë sesa vitin e kaluar dhe 5% më shumë sesa buxheti i planifikuar për këtë vit.

Arsyeja e rritjes së numrit të udhëtarëve dhe të hyrave nga biletat qëndron në ngritjen e nivelit të kontrollit të brendshëm duke i detyruar shumë udhëtarë të cilët kanë qenë të parregullt që të marrin bileta edhe pse ende kemi një kategori që nuk marrin bileta.

**Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i udhëtarëve**

| Përshkrimi- Të hyrat | Janar - Dhjetor |
|---|---|
| Të hyrat nga transporti i udhëtarëve -i kontraktuar | 941,318.00 |
| Të hyrat nga transporti i udhëtarëve -subvencion | 500,000.00 |
| Shitjet nga transporti i udhëtarëve- bileta | 229,844.00 |
| Të ardhurat tjera | 58,542.00 |
| **Total të hyrat** | **1,729,704.00** |
| Shpenzimet direkte në transportin e udhëtarëve | 1,837,257.94 |
| Shpenzimet indirekte në transportin e udhëtarëve | 788,291.94 |
| **Total shpenzimet** | **2,625,549.88** |
| Fitimi/humbja operative | -895,845.88 |

Siç shihet nga tabela më lart biznesi i transportit të udhëtarëve ka operuar me një humbje operative prej **-52 %** gjatë këtij viti raportues.

Vërejtje:
*Shpenzimet indirekte janë përllogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave për vitin 2012 duke marrë për bazë trenkilometrat, ku ka rezultuar se trenat e udhëtarëve kanë operuar rreth 70% nga totali i trenkilometrave që kanë operuar të gjithë trenat.*

## 3.4. PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET

**Treguesit e raportit financiar:**

1. Gjendja financiare janar - dhjetor 2012
2. Gjendja në para të gatshme - raporti sipas bankës (31.12.2012)

### 1. Gjendja financiare janar - dhjetor 2012

Për periudhën raportuese janar - dhjetor 2012 gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzime është siç vijon:

- **TË HYRAT**

Nga **Transporti i mallrave** kemi realizuar të hyrat prej 2,442,720.00€ për periudhën janar - dhjetor 2012. Me rishikim të buxhetit totali i të hyrave të planifikuara për vitin 2012 është 2,004,180.33 € dhe nga kjo del se kemi realizuar 121.88% nga totali. Kjo shumë nuk përfshin në vete të hyrat nga shërbimet tjera që ndërlidhen me transportin e mallrave. Të hyrat nga transporti i mallrave eksport/import janë realizuar sipas kategorive që pasojnë: të hyrat nga importi i kemi realizuar përmes vijës kufitare Hani i Elezit dhe ato janë në shumën 1,551,709.00€ dhe nga eksporti po ashtu përmes vijës kufitare Hani i Elezit kemi realizuar shumën prej 160,785.00€. Transporti i brendshëm kryesisht është realizuar për kompaninë "NewCo Ferronikeli" dhe atë në transportin e xehes nga Medveci dhe thëngjillit nga Kastrioti. Në këtë periudhë nga ky lloj i transportit është realizuar shuma prej 730,226.00€.

Për të prezantuar të hyrat në total sipas linjave të realizuara për transportin e mallrave hyjnë: transporti i mallrave i ndarë sipas klasave (i prezantuar më lart), të hyrat nga kontejnerët, të hyrat nga RIV-i dhe nga vendosja (janë të specifikuara në pozicionin të hyrat nga shërbimet tjera).

**Transporti i udhëtarëve** për periudhën janar - dhjetor 2012 është realizuar në shumën prej 1,671,162.00€. Nga të hyrat e faturuara nga Treni i Lëvizjes së Lirë (TLL) janë 941,318.00€, nga të hyrat e planifikuara nga subvencioni për mbulimin e pjesshëm të humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve kemi realizuar shumën prej 500,000.00€. Burimi i të ardhurave nga biletat është realizuar në shumën prej 229,844.00€. Shprehur në përqindje me realizimin e të hyrave nga transporti i udhëtarëve kemi arritur shumën e realizimit prej 100.38% krahasuar me rishikimin e buxhetit1,664,834.18€ për tërë vitin 2012.

**Të hyrat nga shërbimet tjera** gjatë periudhës janar – dhjetor 2012 kanë arritur shumën prej 264,897.00€. Kjo shumë nëse krahasohet me rishikimin e buxhetit për vitin 2012, e cila është 188,634.74€ arrin kuotën prej 140.42%. Kjo e hyrë është realizuar në

pozicionet siç vijojnë: të hyrat e tjera nga kontejnerët dhe shërbimi për ta – 27,053.00€ dhe të hyrat nga RIV-i dhe vendosjet – 237,844.00€.

Shuma e **Donacionit nga Buxheti i Kosovës** prej 1,200,000.00€ për projektet kapitale të parashikuara, është transferuar një pjesë në vlerë 709,820.56€, për Riparim të Lokomotivës dhe një shumë prej 355,621.13€, për riparim të trenave motorikë.

## • SHPENZIMET

**Shpenzimet** për periudhën janar - dhjetor 2012 janë buxhetuar si dhe janë të klasifikuara në kategoritë që pasojnë:

**Totali i kostos së shërbimit** për periudhën është 3,064,597€ nga 2,955,838.11€ me rishikim të buxhetit për vitin 2012 arrin kuotën prej 103.67%. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2012

**Shpenzimet e stafit** është kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur shumën prej 1,382,906.00€, dhe atë në paga dhe kontribute – 1,363,015.00€ dhe sigurim shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera – 19,891.00€. Në total nëse e krahasojmë periudhën janar – dhjetor me shumën e rishikuar të buxhetit në vlerë 1,403,330.00€ për tërë vitin në këtë kategori kemi arritur kuotën prej 98.54%.

**Totali i shpenzimeve operative** kap shumën prej 207,503.00€, kjo shumë është vetëm 68.76% nga shuma prej 301,760.68€ e rishikuar për vitin 2012. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuar në tabelën e mëposhtme - të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar - dhjetor 2012.

**Totali i shpenzimeve administrative** ka arritur në kuotën prej 80.80%, konkretisht në shumën prej 90,303.00€. Planifikimi vjetor i kësaj kategorie është 323,400.00€, kurse me rishikim parashihen 111,749.29€. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme - të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar - dhjetor 2012. Nga kjo kategori e shpenzimeve vlen të veçohen - shpenzimet logjistike e cila është rritur për shumën e shpenzimit për shitjen e naftës për Infrakos-in e cila nuk është buxhetuar fillimisht as si e hyrë e as si shpenzim, ndërsa me rishikim të buxhetit është planifikuar.


**TABELA 1:** TË HYRAT DHE SHPENZIMET OPERATIVE PËR PERIUDHËN JANAR–DHJETOR 2012

| A | EMËRTIMI | Të hyrat dhe shpenzimet janar-dhjetor2012 | Buxheti i rishikuar 2012 | Diferenca realizimi - buxheti B – C | B/C (%) |
|---|---|---|---|---|---|
| | A | B | C | E | D |
| | SHITJET | | | | |
| 1 | Transporti i mallrave | 2,442,720.00 | 2,004,180.3 | 438,539.7 | 121.88 |
| 2 | Transporti i udhëtarëve | 1,671,162.00 | 1,664,834.1 | 6,327.9 | 100.38 |
| 3 | Shërbimet tjera | 264,897.00 | 188,634.74 | 76,262.26 | 140.42 |
| | TOTAL - Shitjet | 4,378,779.00 | 3,857,649.1 | 521,129.9 | 113.50 |
| B | Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve | | | | |
| 1 | Derivatet dhe lubrifikuesit | 1,245,171.00 | 1,153,419.6 | 91,751.4 | 107.95 |
| 2 | Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale | 18,345.00 | 32,238.86 | -13,898.86 | 56.90 |
| 3 | Inventar dhe pajisje | | 23,835.00 | -23,835.00 | |
| 4 | Material harxhues | 1,947.00 | 2,146.55 | -199.55 | 90.70 |
| 5 | Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera | 115,777.00 | 118,592.25 | -2,815.25 | 97.62 |
| 6 | Qasja në binarë | 1,370,690.00 | 1,386,206.6 | -15,516.6 | 98.88 |
| 7 | Sigurimi i palëve të treta | 5,400.00 | 4,665.6 | 734.4 | 115.74 |
| 8 | Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj | 214,819.00 | 159,903.00 | 54,916.00 | 134.34 |
| 9 | Shpenzimet e transportit Infrakos dhe biletat e shitura | 85,701.00 | 67,303.96 | 18,397.04 | 127.33 |
| 10 | Blerje/shpenzime të tjera | 6,748.00 | 7,527.2 | -779.2 | 89.67 |
| | TOTAL - Kostoja e shërbimit | 3,064,597.00 | 2,955,834.1 | 108,762.9 | 103.67 |
| C(A-B) | Fitimi (humbja) bruto | 1,314,182.00 | 901,815.00 | 412,367.00 | 145.72 |
| D | Të ardhurat tjera | | | | |
| 1 | Të hyrat tjera jo operative | 106,843.00 | 88,887.49 | 17,955.51 | 120.20 |
| | TOTAL - Të ardhurat tjera | 106,843.00 | 88,887.49 | 17,955.51 | 120.20 |
| I | TOTAL -TË HYRAT (A + D) | 4,485,622.00 | 3,946,536.0 | 539,086.00 | 113.65 |
| | Të hyrat e shtyra nga grantet | 1,065,541.21 | 1,200,000.0 | -683,3071.55 | 43.07 |
| E | Shpenzimet e stafit | | | | |
| 1 | Pagat dhe kontributet | 1,363,015.00 | 1,370,014.9 | -6,999.9 | 99.48 |
| 2 | Sigurimi shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera | 19,891.00 | 33,315.08 | -13,424.08 | 59.70 |
| | TOTAL - Shpenzimet e stafit | 1,382,906.00 | 1,403,330 | -20,424.00 | 98.54 |
| F | Shpenzimet operative | | | | |
| 1 | Mirëmbajtja dhe riparimi i objekteve | 11,305.00 | 75,403.64 | -64,098.64 | 14.99 |


| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Sigurimi fizik - total | 38,590.00 | 31,288.12 | 7,301.88 | 123.33 |
| 3 | Shërbimet tjera | 1,351.00 | 2,399.13 | -1,048.13 | 56.31 |
| 4 | Shpenzimet logjistike | 28,900.00 | 19,252.91 | 9,647.09 | 150.10 |
| 5 | Energjia elektrike dhe shërbimet komunale | 34,629.00 | 25,542.43 | 9,086.57 | 135.57 |
| 6 | Sigurimi i palëve të treta | 5,215.00 | 5,754.16 | -539.16 | 90.63 |
| 7 | Donacionet e dhëna | 893.00 | 1,993.10 | -1,100.1 | 44.8 |
| 8 | Marketingu | 14,584.00 | 32,678.32 | -18,094.32 | 44.62 |
| 9 | Udhëtimet zyrtare | 17,602.00 | 18,691.74 | -1,089.74 | 94.16 |
| 10 | Telefonat dhe Posta | 26,815.00 | 22,449.22 | 4,365.78 | 119.44 |
| 11 | Shërbimet bankare | 1,418.00 | 2,294.68 | -876.68 | 61.79 |
| 12 | Tatimet | | 22,569.8 | | |
| 13 | Pajisje elektronike | 26,202.00 | 41,443.43 | -15,241.43 | 63.22 |
| | TOTAL - Shpenzimet operative | 207,503.00 | 301,760.68 | -94,257.68 | 68.76 |
| G | Shpenzimet administrative | | | | |
| 1 | Mbeturinat dhe shërbimet komunale | | | | |
| 2 | Inventar dhe pajisje | 2,879.00 | 11,846.95 | -8,967.95 | 24.30 |
| 3 | Konsulenca dhe auditimi i jashtëm | 5,588.00 | 9,985.00 | -4,397.00 | 55.96 |
| 4 | Material i zyrës | 10,532.00 | 10,201.08 | 330.92 | 103.24 |
| 5 | Material sanitar | 1,107.00 | 5,519.79 | -4,412.79 | 20.05 |
| 6 | Qiraja për objektet | 3,373.00 | 3,386.00 | -13.00 | 99.61 |
| 7 | Reprezentacioni dhe bufeja | 11,410.00 | 10,576.83 | 833.17 | 107.87 |
| 8 | Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet | 36,756.00 | 26,620.00 | 10,136.00 | 138.07 |
| 9 | Shpenzimet logjistike | 3,889.00 | 8,613.64 | -4,724.64 | 45.14 |
| 10 | Kontigjente | 14,768.00 | 25,000.00 | -10,232.00 | 59.07 |
| | TOTAL - shpenzimet administrative | 90,303.00 | 111,749.29 | -21,446.29 | 80.80 |
| II | TOTAL -SHPENZIMET (B+E+F+G) | 4,745,309.00 | 4,772,678.8 | -27,369.8 | 99.42 |
| | Shpenz. e zhvlerësimit të granteve | | | | |
| III | Fitimi (humbja) nga veprimtaria /operacionet | -259,687.00 | - 826,142 | -566,455.80 | 31.43 |
| | Shpenzimet zbritjet e lejuara | 58,151.00 | - | 58,151.00 | |
| I | Shpenzimet e zhvlerësimit | | | | |
| 1 | Shpenzimet e zhvlerësimit që ndikojnë në koston e shërbimit | 43,372.71 | -69,573.48 | -13,817.75 | 80.13 |
| 2 | Shpenzimet e zhvlerësimit që nuk ndikojnë në koston e shërbimit | 109,636.48 | -15,336.00 | 28,436.55 | 285.42 |
| | TOTAL - shpenzimet e zhvlerësimit | 153,009.19 | -84,909.48 | 14,618.75 | 117.21 |
| H | Fitimi (humbja) nga veprimtaria/ operacionet pas zhvlerësimit | -470,847.19 | -911,051.0 | -493,684.77 | 45.81 |

**Sqarim:**
Pjesa e mjeteve të akumuluara në Plan të Rishikuar të Buxhetit nuk është paraparë si e ardhur, por si potencial për t'u përdorur.

**Diagrami 1 – Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit janar – dhjetor 2012**




**Diagrami 2 – Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive janar – dhjetor 2012**




Aktualisht është duke u punuar në barazimin e detyrimeve të klientëve ndaj kompanisë Trainkos Sh.A, dhe detyrimin ndaj furnitorëve të kompanisë Trainkos Sh.A. Gjithashtu jemi në përfundim për futjen e aseteve në programin Alfa.

## 1. Gjendja në para të gatshme - Raporti sipas bankës (31.12.2012)

| Nr | EMËRTIMI | Saldo 31-12-12 |
|---|---|---|
| | PCB nr. 1114-004229-0001-59 | **422,472.03** |
| | PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50 | **24,989.00** |
| | BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41 | **8,842.16** |
| | BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32 | **206.97** |
| | **Totali** | **456,510.16** |

## 3.5. PROGRESI ME PLANIN E BUXHETIT

Implementimi i Planit të Buxhetit për Vitin 2012, në Trainkos Sh.A filloi me mjaft vështirësi të paraqitura si nga aspekti i kushteve klimatike poashtu edhe në aspektin e krizës ekonomike në lëmin e minierave, probleme të cilat reflektuan edhe në progresin në rritje të Planit të Buxhetit për vitin 2012.

Duke ju referuar të hyrave me Planin e Buxhetit 2012, kanë qenë të planifikuara gjithsej 3,946,536.0 ndërsa janë realizuar 4.485.622.00, apo shprehur në % 13.65 më tepër se planifikimi. Ndërsa sa i përket shpenzimeve për vitin 2012 kanë qenë të planifikuara 4,772,678.8, ndërsa janë realizuar 4,745,309.00 apo shprehur në % , - 0,58 më pak se ato të planifikuara.

## 3.6. PROJEKTET KAPITALE TË TRAINKOS SH.A

| Nr | Nr i prok | Titulli i aktivitetit të prokurimit | Data e nënshkrimit të kontratës | Vlera e parashikuar e kontratës | Vlera e Kontratës | Kontraktori |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | TR45003 | **Riparimi i mesëm i trenave motorikë** | 09.06.2012 | 400,000.00 | **405,394.50** | **Quantum doo** |
| 2 | TR45002 | **Riparimi gjeneral i lokomotivës** | 02.07.2012 | 800,000.00 | **796,958.51** | **Cikos Cro Gmbh Gredelj** |
| 3 | TR45016 | **Furnizimi me material harxhues për zyre-ritenderim** | 06.07.2012 | 20,000.00 | **21,585.00** | **Lot1: Blendi LOT 2 Infoprint** |
| 4 | TR45015 | **Shërbimet e sigurimit të palëve të treta** | 25.05.2012 | 15,000.00 | **10,800.00** | **Siguria sh.a.** |
| 5 | TR45023 | **Furnizimi me 120 ton dizel** | 03.12.2012 | 140,000.00 | **125,300.97** | **Petrol Oti** |
| 6 | TR45004 | **Renovimi i objektit të ish-ambulantes pronë e Trainkos Sh.A** | 04.05.2012 | 50,000.00 | **51,789.00** | **Area Shpk** |
| 7 | TR45010 | **Furnizimi me pajisje të IT-së** | 19.06.2012 | 13,500.00 | **14,200.00** | **EuroPrinty** |
| 8 | TR45012 | **Furnizimi me filtra për lokomotiva** | 11.05.2012 | 10,000.00 | **8,936.64** | **Mimi Co** |
| 9 | TR45014 | **Furnizimi me dizel** | 01.06.2012 | 1,500,000.00 | **1,411,527.00** | **Bajraktari Shpk** |
| 10 | TR45016 | **Furnizimi me material harxhues për zyre** | 06.07.2012 | 14,000.00 | **14,362.00** | **NTG Blendi** |
| 11 | TR45018 | **Furnizimi me konvertorë për vagonë të udhëtarëve** | 16.07.2012 | 30,000.00 | **28,826.00** | **Euro Trade** |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 | TR45020 | **Furnizimi me pije për bufe** | 26.07.2012 | 8,000.00 | **13,625.00** | **Pashtriku** |
| 13 | TR45021 | **Shërbimet e shtypjes së formularëve** | 21.01.2012 | 10,000.00 | **7,714.00** | **Trendi** |
| 14 | TR42003 | **Furnizimi me mobile për Administratë** | 01.02.2012 | 1,540.00 | **5,044.00** | **NT Elektro commerc** |
| 15 | TR42004 | **Shërbimet e autolarjes për veturat e Trainkos-it** | 13.02.2012 | 3,000.00 | **3,000.00** | **Auto serivce VALI** |
| 16 | TR42006 | **Kalibrimi i pompës me presion të lartë** | 18.01.2012 | 2,000.00 | **1,584.00** | **VIP element doo** |
| 17 | TR42007 | **Furnizimi me nxemse për MMlL-në** | 23.02.2012 | 3.400.00 | **3,300.00** | **Arsimi sh.p.k** |
| 18 | TR42008 | **Ndarja e zareve për personel** | 09.03.2012 | 1,500.00 | **1,222.22** | **Wiena sh.p.k** |
| 19 | TR42010 | **Furnizimi me mobile** | 02.05.2012 | 3,950.00 | **1,950.00** | **Pallma** |
| 20 | TR42011 | **Furnizimi me invertor për lokomotivë** | 20.04.2012 | 5,080.00 | **4,340.00** | **N.T.SH. Profitech** |
| 21 | TR42012 | **Furnizimi me sensorë për matës të shpejtësisë për lokomotiva** | 11.06.2012 | 2,000.00 | **1,495.00** | **Shpk Allmakos Group** |
| 22 | TR42013 | **Furnizimi me material për mjete lëvizëse** | 28.05.2012 | 4,700.00 | **4,480.00** | **N.T.P Edi co** |
| 23 | TR42014 | **Furnizimi me kompjuterë** | 03.05.2012 | 13,500.00 | **2,947.00** | **N.T.SH infoprint** |
| 24 | TR42015 | **Furnizimi me pajisje për trenin ndihmës** | 11.06.2012 | 1,160.00 | **1,160.00** | **N.p.m Torno** |
| 25 | TR42016 | **Furnizimi me kompjuterë për nevojat e Trainkos Sh.A** | 26.09.2012 | 5,586.00 | **5,458.00** | **City computer** |
| 26 | TR42017 | **Furnizimi me bateri për personel** | 15.06.2012 | 1,199.00 | **1,197.00** | **N.T.SH ALBERTI** |
| 27 | TR42018 | **Furnizimi me material elektrik** | 20.07.2012 | 8,600.00 | **8,651.60** | **Arhiko Ing** |
| 28 | TR4219 | **Sigurimi kasko i veturave** | 26.07.2012 | 4,000.00 | **3,593.00** | **K.S Illyria** |
| 29 | TR42020 | **Furnizimi me filtra të ajrit** | 12.07.2012 | 4,600.00 | **2,954.00** | **N.t.sh Profitech** |
| 30 | TR42021 | **Furnizimi me susta për lokomotivën 008** | 01.08.2012 | 7,000.00 | **6,920.00** | **NTP Edi Co** |
| 31 | TR42024 | **Furnizimi me shkop grafiti për lyrësen e rrotave të lokomotivës"** | 06.09.2012 | 1,500.00 | **1,500.00** | **NTP Edi Co** |
| 32 | TR42025 | **Furnizimi dhe riparimi ngrohtores në MML** | 09.11.2012 | 5,000.00 | **6,468.00** | **Ejona** |
| 33 | TR42026 | **Shërbimet e transportit të udhëtarëve** | 23.10.2012 | 7,440.00 | **2,700.00** | **Florimi** |
| 34 | TR42027 | **Ndërtimi i objektit të furnizuesve të naftës dhe shtëpisë së rezervuarit** | 07.11.2012 | 5,000.00 | **5,730.19** | **Brother Group** |
| 35 | TR42027 | **Renovimi i zyrës së serverit** | 29.10.2012 | 6,200.00 | **6,084.00** | **General Group** |
| 36 | TR42028 | **Furnizimi me rërë për lokomotiva** | 15.10.2012 | 1,500.00 | **2,088.00** | **Auto Kosova** |
| 37 | TR42016 | **Furnizimi me kompjuter kontrollë për lok. 009** | 26.09.2012 | 9,985.00 | **9,985.00** | **NTSH PROFITECH** |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 38 | TR42031 | **Furnizimi me susta për lokomotivën 005** | 16.10.2012 | 7,000.00 | **6,217.00** | **Mimi Co** |
| 39 | TR43001 | **Furnizimi me materiale të ndryshme për departamentet e Trainkos – vlera të vogla të akumuluara** | 11.01.2012 | 27,860.00 | **26,649.92** | **Të ndryshme** |
| | | **TOTALI :** | | **3,151,400.00** | **3,037,736.55** | |

**Riparimi i mesëm i trenave motorikë –** është projekt i financuar nga Buxheti i Kosovës. Për këtë projekt janë ndarë 400,000.00€. Në të janë paraparë të riparohen dy nga trenat motorikë Y1 të prodhimit suedez. Projekti nuk ka pësuar ndryshim në koston e implementimit, por janë shkaktuar vonesa në implementimin e projektit të cilat vonesa janë shkaktuar nga kontraktori si implementues i kontratës.

**Riparimi gjeneral i lokomotivës 661** - është projekt i cili financohet nga Buxheti i Kosovës dhe për këtë projekt janë ndarë 800,000.00€. Projekti për Riparimin gjeneral të lokomotivës po ashtu nuk ka pësuar ndonjë ndryshim në koston e implementimit të projektit, por janë shkaktuar vonesa me rastin e tenderimit deri te kontraktimi si dhe vonesa tjera të shkaktuara nga kontraktori si implementues i kontratës. Vonesat në tenderim janë shkaktuar në mungesë të ofertuesve të përgjegjshëm.

## 3.7. P ERSPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHËM

**Objektivat ekonomike për vitin 2013**

- Ngritja e një bashkëpunimi të qëndrueshëm me operatorët rajonalë dhe atyre nga vendet e BE-së në transportin hekurudhor me qëllim të shkëmbimit të përvojave të suksesshme.
- Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve teknike dhe resurseve njerëzore.
- Të rrisim shërbimet dhe cilësinë e tyre në transportin hekurudhor, për një zhvillim të vazhdueshëm të ndërmarrjes.
- Objektivi në tregun e transportit të udhëtarëve është që të kemi një nivel të njëjtë apo të përafërt me vitin 2012;
- Në shërbimin e mirëmbajtjes së vagonave të kemi një rritje prej 4% në krahasim me vitin 2012;

- Rritja në transportin e mallrave për 7% në krahasim me atë të vitit 2012;
- Niveli i inkasimit të borxheve (arkëtueshmeve) të mëparshme të jetë >45%.

## Objektivat tjera të kompanisë për vitin 2013

- Ngritja e sigurisë në komunikacionin hekurudhor;
- Përmirësimi i proceseve të brendshme;
- Ngritja e efikasitetit në realizimin e projekteve;
- Përmirësimi i nivelit të shërbimeve;
- Përmirësimi i komoditetit për udhëtarët;
- Përmirësimi i gjendjes së parkut lëvizës karshi plotësimit të nevojave operative për mjetet lëvizëse;
- Ngritja profesionale dhe ripërtëritja e stafit;
- Përmirësimi i strukturës gjinore;
- Promovimi i shërbimeve tona në nivel gjithëpërfshirës;
- Hulumtimi i tregut dhe kuptimi më i mirë i kërkesave në treg;
- Përmirësimi i sistemit të komunikimit brenda dhe me klientë;
- Rritja e  efektivitetit në dhënien e shërbimeve;
- Ndryshimi i kulturës biznesore të punonjësve të kompanisë bazuar në të arriturat e reja teknologjike;
- Përmirësimi i kushteve të punës për stafin.

## 3.8. R REZIQET E SË ARDHMES SË KORPORATËS

Në këtë pjesë ne kemi paraqitur disa nga rreziqet të cilat i kanosen kompanisë sonë në të ardhmen dhe për të cilat duhet punuar që t'i minimizojmë efektet e tyre.


- Mosmbulimi i shpenzimeve të Transportit të Udhëtarëve sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës;
- Kostoja e lartë e investimeve në mjetet lëvizëse;
- Kontestet e shumta gjyqësore;
- Pamundësia e kontrollit të procesit të ofrimit të shërbimit për transportimin e mallrave të importuara apo të eksportuara vetëm nga ana jonë për shkak të përfshirjes të më shumë operatorëve hekurudhorë në ofrimin e këtij shërbimi;
- Gjendja jo e mirë e infrastrukturës hekurudhore dhe kufizimet që shkaktohen në operim qoftë në aspektin e shpejtësisë ashtu edhe në operimin 24/7;
- Futja e operatorëve të rinj në treg;
- Obstruksionet e vazhdueshme nga Hekurudhat Serbe dhe bllokimi i daljes veriore për në Serbi;
- Mungesa e bazës ligjore që rregullon politikën e transportit në Kosovë gjegjësisht moszbatimi i saj;
- Fleksibiliteti i konkurrentëve tanë në aspektin e shpejtësisë, dërgesës, çmimit, etj.

# 4. RAPORTI SIPAS LIGJIT MBI NDËRMARRJE PUBLIKE

## 4.1. STRUKTURA ORGANIZATIVE E TRAINKOS SH.A

**Skema organizative e Trainkos Sh.A**

Operimi me trena në Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A. vitin 2012 e ka filluar me një strukturë më të konsoliduar se në vitin 2011. Procesi i ndarjes së Hekurudhave të Kosovës për kompaninë e re, Trainkos Sh.A. kishte parashtruar shumë detyra, ndër to ishte edhe konsolidimi i stafit të saj. Potenciali njerëzor i punonjësve në fillim të vitit 2012 ka qenë i sistemuar në bazë të përgatitjes së tyre dhe nevojave që ka kërkuar vetë procesi i punës. Shpërndarjes dhe sistemimit të tyre i ka paraprirë skema organizative e kompanisë e cila është ndërtuar në bazë të nevojave të punës të cilën do ta paraqesim në vijim:




***Skema organizative e Trainkos Sh.A***

Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, mosha e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në Trainkos Sh.A është si vijon:

| Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të Trainkos Sh.A më 1 janar 2012 dhe më 31 dhjetor 2012 | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Totali i të punësuarve** | | | **01.01.2012** | | **31.12.2012** | | |
| | | | **199** | | **221** | | |
| **Mosha mesatare e punëtorëve** | **01.01.2012** | **31.12.2012** | **Vlerat në numra** | | **Vlerat në përqindje** | | |
| | **47.85** | **47.16** | **01.01.2012** | **31.12.2012** | **01.01.2012** | **31.12.2012** | |
| **Me marrëdhënie të rregullt pune** | | | **193** | **212** | **96.98%** | **95.92%** | **Format e kontratave** |
| **Me kontratë për punë dhe detyra specifike** | | | **6** | **9** | **3.01%** | **4.07%** | |
| **Me kontratë të paafatizuar** | | | **97** | **95** | **48.74%** | **42.98%** | |
| **Me kontratë të afatizuar** | | | **102** | **126** | **51.25%** | **57.01%** | |
| **Meshkuj** | | | **188** | **201** | **94.47%** | **90.95%** | **Gjinia** |
| **Femra** | | | **11** | **20** | **5.52%** | **9.49%** | |
| **Serbë** | | | **7** | **2** | **3.51%** | **0.90 %** | **Nacion a.** |
| **Shqiptarë** | | | **192** | **219** | **96.48%** | **99.09%** | |
| **Me shkollim fillor** | | | **19** | **19** | **9.54%** | **8.59%** | **Përgatitja shkollore** |
| **Me shkollim të mesëm** | | | **149** | **153** | **74.87%** | **69.23%** | |
| **Me shkollim të lartë** | | | **4** | **5** | **2.01%** | **2.62%** | |
| **Me shkollim superior** | | | **27** | **44** | **13.56%** | **19.90%** | |
| **Zyrtarët e lartë** | | | **4** | **4** | **1.99%** | **1.80%** | **Sektorët e punësimit** |
| **Departamenti i Bizneseve Operuese** | | | **165** | **162** | **78.60%** | **73.30%** | |
| **Departamenti i Administratës** | | | **19** | **37** | **16.41%** | **16.74%** | |
| **Departamenti i Prokurimit** | | | **2** | **4** | **0.99%** | **1.80%** | |
| **Departamenti i Financave** | | | **3** | **5** | **1.99%** | **2.62%** | |
| **Me kontratë Specifike** | | | **6** | **9** | **3.01%** | **4.07%** | |

**Vërejtje:**
**Tabela më lart nuk përmban anëtarët e Bordit të Drejtorëve.**

**Sqarim i tabelës të paraqitur më lart:**

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë bërë transferime të brendshme të cilat kanë ndikuar që në pozita të ndryshme të rritet kualiteti, efikasiteti dhe disiplina në punë. Këto transferime-ndryshime kanë qenë të nevojshme për shkak të procesit të punës që është zhvilluar duke plotësuar ato zbrazëtira që kanë mbetur nga ndarja e Hekurudhave të Kosovës, por nuk kanë ndikuar në të dhënat në kategorizim.

Brenda periudhës njëvjeçare (01.01.2012 - 31.12.2012), në numrin e përgjithshëm të të punësuarve ka pasur disa ndryshime të cilat kanë reflektuar edhe në përqindje në strukturën e përgjithshme të të punësuarve. Në tabelën në vijim do të paraqesim gjendjen e të punësuarve në kompani më 01.01 2012 dhe atë më 31.12.2012 duke filluar nga numri i përgjithshëm i punonjësve, mosha mesatare, punëtorët me kontratë të afatizuar dhe të pa afatizuar etj.

Totali i të punësuarve më 01.01.2012 është 199. Nga totali i të punësuarve 6 janë punëtorë jo të rregullt ose me kontratë për punë dhe detyra specifike, ndërsa 193 janë të rregullt.

Totali i të punësuarve më 31.12.2012 është 221. 212 janë punëtorë të rregullt ndërsa 9 janë punëtorë me kontratë për punë dhe detyra specifike.

Vlen të sqarohet se si prioritet i RNJ për vitin 2012 ka qenë rritja e të punësuarve të gjinisë femërore kështu që përqindja brenda 12 muajve është ngritur nga 5.52% në 9.49%. Të arritura ka pasur edhe sa i përket zvogëlimit të moshës mesatare ku për 12 muaj mosha mesatare është zvogëluar nga 47.85 në 47.16 . Po ashtu është e nevojshme të sqarohet se kjo listë nuk mund të përputhet me listën e pagave për faktin se një punëtor është në pushim mjekësor pa pagesë.

## 4.2. KONTESTET GJYQËSORE NË PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2012

Gjatë periudhës njëvjeçare Zyra Ligjore e Trainkos Sh A ka mbajtur gjithsej 35 seanca gjyqësore. Kontestet Gjyqësore janë një nga rreziqet kryesore të kompanisë, sidomos kontestet e punës. Këto procese janë të trashëguara nga ish –Hekurudhat e Kosovës, si rezultat edhe i mospërfilljes së procedurave dhe kontratave nga menaxhmenti i asaj kohe.

Zyra Ligjore funksionon  në kuadër të Departamentit të Administratës, me qëllim të përfaqësimit, ruajtjes dhe mbrojtjes së interesave të kompanisë, duke u bazuar në këtë ka ndërmarr të gjitha veprimet në sigurimin e të gjitha provave elementare për ta mbrojtur kompaninë nga paditësit që kanë ngritur padi kundër Trainkos Sh A për kompensimin e dëmeve materiale dhe jo materiale duke u bazuar në aktet normative të aplikueshme në Trainkos Sh A si dhe në propozimin e nxjerrjes së provave përmes ekspertizave dhe superekspertizave në rastet e mungesës së disa provave me qëllim të konstatimit të përgjegjësisë–kontributit të pjesëmarrësve në komunikacionin hekurudhor dhe zgjidhjes së këtyre kontesteve në favor të kompanisë. Të gjitha këto aspekte janë trajtuar  në mënyrë të përgjegjshme dhe profesionale nga Zyra Ligjore e Kompanisë.

## 4.3. KONTESTET GJYQËSORE TË PRITURA NË VITIN 2013

Hekurudhat e Kosovës Trainkos SH.A për vitin 2013 kanë gjithsej 61 konteste gjyqësore që nga procedura fillestare e deri të revizioni. Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i kontesteve të hapura dhe kategorizimi i tyre për të cilat mund të kemi ftesë nga gjykatat gjatë vitit 2013.

| Kategoritë e kontesteve | Numri i kontesteve |
|---|---|
| Kontestet nga marrëdhënia e punës | 35 |
| Kontestet për kompensim të dëmit | 18 |
| Kontestet për pagimin e borxhit | 6 |
| Penale | 2 |

Në bazë të kësaj gjendje, kontestet gjyqësore mbesin si një ndër rreziqet më të mëdha të kompanisë pasi që kontestet gjyqësore janë në numër shumë të madh si dhe me një vlerë të lartë financiare. Në rast të humbjes të ndonjë kontesti kompania do të dëmtohet financiarisht. Kontestet janë si rrjedhojë e menaxhimit jo të mirë të kompanisë sa ishte nën administrim të UNMIK-ut dhe një pjesë e madhe edhe pas daljes së kompanisë nga administrimi i UNMIK-ut.

## 4.4. TRANSAKSIONET E REALIZUARA JANAR- DHJETOR 2012

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse dhe ato në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës:

| **Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse** | |
|---|---|
| Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2012 | 360,369.68 |
| Pagesat e kryera gjatë muajve janar- dhjetor 2012 | 4,409,456.65 |
| Inkasimet e pranuara gjatë muajve janar- dhjetor 2012 | 4,471,687.10 |
| Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2012 | 422,472.03 |

| **Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës** | |
|---|---|
| Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2012 | 24,163.49 |
| Inkasimet e pranuara gjatë muajve janar- dhjetor 2012 | 1,065,441.69 |
| Pagesat e kryera gjatë muajve janar- dhjetor 2012 | 1,080,763.02 |
| Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2012 | 8842 |

## 5. PËRFUNDIM

Ky raport vjetor i NP Traikos Sh.A paraqet në mënyrë të përmbledhur përveç pasqyrës së aktiviteteve tona të përfunduara edhe synimet tona për të ardhmen e kompanisë e cila besojmë se do të jetë edhe më funksionale në një të ardhme të afërt, bazuar në misionin që ka dhe në vizionin që kemi ngritur për të avancuar tutje.

Të vetëdijshëm se një mision si ky yni që të jemi bartës të zhvillimit ekonomik të vendit duke ofruar zgjedhje konkurruese të transportit dhe me këtë të përmirësojmë mirëqenien e qytetarëve tanë, kërkon angazhim të shtuar, ne po i bëjmë të gjithë hapat e nevojshëm për ta përmbushur këtë në të ardhmen duke u siguruar në një angazhim të madh të stafit menaxherial e profesional. Ne kemi ndërtuar vizonin tonë në bazë të analizave që kemi bërë dhe në bazë të këtij vizoni që kemi mendojmë të jemi prijës në transportin e mallrave e sidomos të industrive të rënda brenda vendit me një rritje të vazhdueshme për t'u zgjeruar në rajon si dhe me shërbime konkurruese, komode dhe me saktësi të lartë të jemi zgjedhja e parë e udhëtimit për pjesën më të madhe të qytetarëve të vendit. Duke besuar në qëndrueshmëri financiare dhe ngritje të vazhdueshme, puna jonë të jetë burim i vazhdueshëm i besueshmërisë së klientëve tanë dhe krenarisë për ne.

Bazuar në vizionin tonë, në vitin 2012 fokusi ynë ka qenë orientimi në plotësimin e detyrimeve tona karshi konsumatorëve tanë si dhe publikut të gjerë. Duke marrë parasysh kategoritë e ndryshme të konsumatorëve tanë dhe meqenëse shërbimet tona i drejtohen më shumë se një tregu, ne i kemi ndërlidhur disa detyrime bazë që mendojmë t'i mbajmë drejt secilës kategori të konsumatorëve. Transparenca, korrektësia dhe trajtimi jo diskriminues do të jenë detyrimet më karakteristike të punës sonë. Sikur në ofrimin e shërbimeve të transportit të mallrave apo udhëtarëve po ashtu në mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse, ne mendojmë që në të ardhmen të zhvillojmë edhe më shumë angazhimet tona drejt këtyre detyrimeve, në mënyrë që konsumatorët tanë të jenë të kënaqur me raportin me ne si partner i tyre.

Si përfundim mund të themi së gjate vitit 2012 kemi përmbushur objektivat tona operative dhe veçmas ato financiare duke tejkaluar planifikimet financiare për rreth 21.88% dhe si rrjedhojë kompania ka përmbyllur vitin 2012 me fitime. Ky sukses i arritur në vitit 2012 është një tregues se strategjia jonë po tregon rezultate pozitive dhe për këtë një meritë të jashtëzakonshme e ka i gjithë stafi i kompanisë. Menaxhmenti i Trainkos mbetet i angazhuar në përmbushjen e objektivave strategjike të kompanisë si dhe misionit dhe vizionit të saj.

***Mars 2013***

**Betim Gjoshi**

**Kryeshef Ekzekutiv i Trainkos Sh.A**